

EPOKA ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7189
E hënë, 20 maj 2024
Çmimi 0.50

Thaçit i shkojnë prindërit për vizitë në Hagë | PAGE 3



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH CMDB
www.awr-abbruch.de

NËNSEKRETARJA AMERIKANE: ASOCIACIONI, HAP THELBËSOR NË RRUGËTIMIN EUROATLANTIK TË KOSOVËS



Nënsëkretarja amerikane e Shtetit për Diplomaci dhe Çështje Publike, Liz Allen, pas takimit të dielën me presidenten e Kosovës, Vjosa

Osmani, ka thënë se me këtë të fundit ka biseduar për shumë çështje, ndër to edhe për themelimin e Asociacionit të Komunave me

Shumicë Serbe. Ajo ka thënë se themelimi i Asociacionit është hap thelbësor në rrugëtimin euroatlantik të Kosovës

AKTUALE



KRYEMINISTRI SLOVAK NUK ËSHTË MË NË RREZIK PËR JETË F. 2

HAMZA NË ZVICËR TAKOHET ME BASHKADHETARË: JANË SHYLLË E PAMOHUESHME EKONOMIKE F. 5

ARRATISJA E SEKIROAËS, HAXHIU: KY RAST NGRE DYSHIME PËR PËRFSHIRJE TË GJYQËSORIT NË KORRUPSION F. 6

EKONOMI



KURTI PËR REFORMËN E ASISTENCËS SOCIALE: DO TË KRIJOJË BARAZI DHE DO TË NXISË PUNËSIMIN F. 7

PRODHUESIT VENDORË ANKOHEN PËR MOSPËRKRAHJE NGA SHETETI F. 8

SPORT



TRIUMFON YLLI, TITULLI VENDOSËT NË MITROVICË F. 12

**ANALISTËT:
ZHVILLIMET RRETH
KËSHILLIT TË
EVROPËS RREZIKOJNË
TA ULIN RITMIN
E INTEGRIMIT
EVROPIAN
TË KOSOVËS F. 3**



**KOSOVA DHE SHBA-JA NËNSHKRUAJNË
MARRËVESHJE KUNDËR
MANIPULIMIT TË INFORMACIONIT
NGA SHTETET E HUAJA F. 3**



RENOVA
PUTZ
Mogeloni
Xhugllëkë - Tetovë
Gurë/Petrolj
E-mail: renova@mt.net.mk
Tel: +389 44 487 302 / +389 44 487 070 / +389 44 487 753
Fax: +389 44 487 200
Më: +389 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.PK.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-kc.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYRKOL • BUNJAKOL • CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
028 500 870 | 045 500 870
044 500 870 | 049 500 870

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SH.PK. RTZALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.PK.
SHBA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 10339 246 301 Fax: +381 10339 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

OKB-ja paralajmëron për "mizori" të tjera në Mianmar

NYU-JORK, 19 MAJ - Agjencia e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat të Njeriut ka thënë se është "thellësisht e alarmuar" nga rritimi i dhunës në rajonin Rakhine të Mianmarit [shtet i njohur edhe si Burma], dhe ka paralajmëruar për "mizori" të tjera.

Përleshjet janë përhapur në Rakhine prej kur ushtria Arakan i ka sulmuar forcat e sigurisë në nëntor, duke i dhënë fund një armëpushimi të zbatuar qysh prej pucit ushtarak të vitit 2021. "Jam thellësisht i alarmuar nga raportimet për rritim të dhunës dhe shkatërrim të pronës në rajonin Rakhine, në veri të Mianmarit, çka ka rezultuar me zhvendosje të dhjetëra mijëra

civilëve, kryesisht Rohingya", ka thënë shefi i agjencisë së OKB-së, Volker Turk, përmes një deklarate.

Turk ka thënë se Kombet e Bashkuara po synojnë të mbledhin informacion për "shkelje serioze". "Me tensione të larta mes komuniteteve, banorëve etnikë të Rakhines dhe atyre Rohingya, e të cilat po nxiten vazhdimisht prej ushtrisë, kjo është një periudhë kritike, pasi rreziku për mizori të tjera është akut".

Ushtria Arakan është një prej shumë grupeve etnike të armatosura në rajonet kufitare të Mianmarit të cilat kanë luftuar me ushtrinë prej pavarësisë nga Britania më 1948 për shkak të

autonomisë dhe kontrollit të burimeve natyrore.

Ushtria Arakan pretendon se po lufton për më shumë autonomi për popullatën etnike të rajonit Rakhine.

Luftimet janë përhapur në 15 prej 17 vendbanimeve prej muajit nëntor të vitit të kaluar dhe prej atëherë janë vrarë qindra njerëz dhe rreth 300 000 janë plagosur.

Turk i ka bërë thirrje Bangladeshit fqinj që ta rrisë mbrojtjen për "njerëzit e cenusëm që kanë nevojë për siguri".

Përleshjet mes ushtrisë Arakan dhe ushtrisë së shtetit më 2019 patën rezultuar me zhvendosje të rreth 200 000 njerëzve.

Në atë rajon ushtria e shtetit pati nisur shtypjen e minoritetit



Rohingya, dhe tani në gjykatën e Kombeve të Bashkuara po trajtohet një rast nën dyshim të për gjenocid për atë periudhë.

Arrihet pajtueshmëri për tekstin përfundimtar të rezolutës për Srebrenicën

SARAJEVË, 19 MAJ - Ambasadori i Bosnje-Hercegovinës në Kombet e Bashkuara, Zlatko Lagumxhija, ka njoftuar se është arritur pajtueshmëri për tekstin përfundimtar të rezolutës për gjenocidin në Srebrenicë.

Ndryshimet në rezolutën që e ka parë Radio Evropa e Lirë përfshijnë shprehjen "sipas të drejtës ndërkombëtare" dhe shprehja "jokolektive" është zëvendësuar me "individuale".

"Ne kemi qenë të heshtur ndaj mohuesve të gjenocidit teksa ata kanë festuar dhe kanë 'caktuar' e më pas 'anuluar' mbledhje joekzistente të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, si dhe bënin vlerësime për 'Rezolutën gjenocidin në Srebrenicë më 1995' para se ta lexonin dhe para se të finalizohet teksti", ka thënë Lagumxhija në një postim në "X".

Sipas tij, "fjala e vetme që u pengon atyre është gjenocidit".

Ndonëse për tekstin e rezolutës në parim janë pajtuar shumë vende që e kanë përkrahur nisnëm, Mali i Zi ka kërkuar disa ndryshime shtesë. "Srebrenica isa



ka marrë vëmendjen globale në muajt e fundit - si simbol i luftës për drejtësi, të vërtetës, pajtimit, mësimi dhe si simbol i luftës kundër mohimit të gjenocidit. Askush nuk mund të ikë nga kjo më", ka thënë ambasadori.

Sipas tij, rishikimi final i rezolutës, që do të prezantohet para të gjitha vendeve anëtare të Kombeve të Bashkuara më 23 maj, ka rezultuar me një tekst edhe më të thuktë.

Ai ka thënë se pas ndryshimit të

parë, tani në tekst përmendet se "përgjegjësia kriminale, nën ligjin ndërkombëtar, për krimin e gjenocidit, nuk mund të aplikohet ndaj asnjë komuniteti etnik apo fetar në tërësi".

Teksti më pas thotë "ne konfirmojnë përkushtimin tonë për të mbajtur dhe forcuar unitetin në diversitetin e Bosnjë-Hercegovinës".

Rezoluta e iniciuar prej Gjermanisë dhe Ruandës kërkon që 11 korriku të shpallet Ditë

Ndërkombëtare për Kujtimin e Gjenocidit në Srebrenicë.

Rezoluta u referohet fakteve të gjykatave ndërkombëtare dhe atyre vendase.

Për gjenocidin ndaj mbi 8 000 burrave dhe djemve myslimanë në rajonin e Srebrenicës më 1995, janë dënuar më shumë se 50 persona me gati 700 vjet burgim.

Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë e njeh këtë akt si gjenocid.

Ky krim konsiderohet më i rëndi

në Evropë pas Luftës së Dytë Botërore dhe për të janë dënuar më shumë se 50 persona me rreth 700 vjet burgim gjithsej.

Në mesin e tyre janë edhe presidenti i kohës së luftës i Republikës Sërpska, Radovan Karaxhiq, dhe komandanti i përgjithshëm i ushtrisë së atëherëshme të serbëve të Bosnjës, Ratko Mlladiq.

Pavarësisht prej vendimeve të gjykatave ndërkombëtare, Beogradi zyrtar dhe autoritetet e entitetit serb të Bosnjë-Hercegovinës, Republikës Sërpska, nuk e pranojnë të jetë kryer gjenocid në Srebrenicë.

Presidenti serb Aleksandar Vuçiq e ka quajtur këtë rezolutë si deklaratë politike.

Ai ka pyetur nëse synimi është "rishikimi i një padie kundër Serbisë, apo mbledhja e dëmeve të luftës?".

Në rezolutë nuk përmendet asnjë komb dhe shtet.

Brukseli ka thënë më 14 maj se nuk ka vend në Bashkimin Evropian për ata që nuk e dënojnë gjenocidin në Srebrenicë.

Kryeministri sllovak nuk është më në rrezik për jetë

BRATISLAVË, 19 MAJ - Jeta e kryeministrit sllovak Robert Fico nuk është më në rrezik pas atentatit me të cilin është përballur ditë më parë, ka thënë zëvendëskryeministri i Sllovakisë, Robert Kalinak, të dielën. "Ai nuk është më në rrezik për jetë, por gjendja e tij vazhdon të jetë serioze dhe duhet të jetë në kujdes intensiv", ka thënë Kalinak, aleati më i ngushtë politik i Ficos.

Personi i akuzuar për tentimvrasje të kryeministrit ka dalë të shtunën para gjykatës.

I akuzuari, i identifikuar nga mediet sllovake si Juraj Cintula, 71-vjeçar, e ka qëlluar me armë Ficon pas një takimi qeveritar të mërkurën.

Cintula ka shtënë pesë herë me armë kundër Ficos, ndërsa e ka qëlluar katër herë - përfshirë goditjen në abdomen teksa kryeministri

ka qenë në afërsi të mbështetësve të tij, pas takimit qeveritar të zhvilluar në qytezën Handlova.

Fico është dërguar në spital me helikopter dhe i është nënshtruar një operimi për pesë orë, si dhe një operimi tjetër dyorësh të premtën.

Fico është në pushtet prej kur partia e tij popullsit e qendrës, Smer, i ka fituar zgjedhjet e përgjithshme në jeshitën e vitit të kaluar.



Nënsekretarja amerikane: Asociacioni, hap thelbësor në rrugëtimin euroatlantik të Kosovës

Nënsekretarja amerikane e Shtetit për Diplomaci dhe Çështje Publike, Liz Allen, pas takimit të dielën me presidenten e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë se me këtë të fundit ka biseduar për shumë çështje, ndër to edhe për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Ajo ka thënë se themelimi i Asociacionit është hap thelbësor në rrugëtimin euroatlantik të Kosovës

EPOKA
ER **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 19 MAJ - Nënsekretarja amerikane e Shtetit për Diplomaci dhe Çështje Publike, Liz Allen, e ka konsideruar formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë, hap thelbësor për jetësimin e synimeve euroatlantike të Kosovës. Ajo i ka bërë këto deklaratat pas takimit të zhvilluar të dielën me presidenten e Kosovës, Vjosa Osmani. "Konfirmoj se ne mbështesim trajektoren e Kosovës drejt institucioneve euroatlantike përmes bashkëpunimit të ngushtë dhe e di se kjo është me rëndësi për ju. Diskutoam për hapin thelbësor në rrugëtimin euroatlantik të Kosovës, Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe",

ka thënë Allen. Bërtja e hapave drejt Asociacionit ka qenë kusht për Kosovën edhe për anëtarësim në Këshillin e Evropës - organizatën lidere në fushën e të drejtave të njeriut - më herët gjatë javës.

Një ditë para mbledhjes së Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, autoritetet e Kosovës kanë thënë se gjatë muajit maj do të dërgojnë për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës një propozim për formim të Asociacionit, mirëpo zyrtarë të lartë të Perëndimit kanë thënë se diçka e tillë është e pamjaftueshme për ta plotësuar kushtin.

Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës mbledhjet një herë në vit dhe mbetet e paqartë se kur Kosova do të mund të bëhet anëtare e organizatës



Pas takimit, Osmani dhe Allen kanë nënshkruar një marrëveshje mirëkuptimi në mes të Shteteve të Bashkuara dhe Kosovës kundër manipulimit të informacionit nga shtetet e huaja.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë se vizita e zyrtares Allen simbolizon partneritetin e palëkundur mes Shteteve të Bashkuara dhe Kosovës si dhe dëshmon përkushtimin e ndërsjellë për bashkëpunim, me qëllim të luftimit të sfidave të përbashkëta.

"Në dritë të zhvillimeve dhe dinamikave globale, padyshim se sfidat shtohen. Mirëpo, bashkëpunimi ynë është materializuar në mënyra të jashtëzakonshme", ka thënë presidentja, duke përmendur një mori marrëveshjesh të nënshkruara me agjenci amerikane që veprojnë në Kosovë.

Allen ka qenë për vizitë edhe në Serbi më 15 maj. Atje është takuar me presidentin e shtetit, Aleksandar Vuçiq, me të

cilën, mes të tjerash, ka biseduar për rëndësinë e përpimit në dialogun me Kosovën.

Kosova dhe Serbia dialogojnë në Bruksel për normalizim të marrëdhënieve qysh prej vitit 2011.

Palët kanë nënshkruar një mori marrëveshjesh, por jo të gjitha janë zbatuar. Bashkimi Evropian ka përsëritur disa herë se zgjidhja e të gjitha problemeve mes dy vendeve është faktor tejet i rëndësishëm për rrugën e tyre evropiane.

Kosova dhe ShBA-ja nënshkruajnë marrëveshje kundër manipulimit të informacionit nga shtetet e huaja

EPOKA
ER **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 19 MAJ - Presidentja Vjosa Osmani dhe nënsekretarja amerikane e Shtetit për Diplomaci dhe Çështje Publike, Liz Allen, kanë nënshkruar të dielën në Prishtinë një marrëveshje mirëkuptimi mes Shteteve të Bashkuara dhe Kosovës kundër manipulimit të informacionit nga shtetet e huaja.

Osmani ka thënë se marrëveshja e saponëshkruar do të ndihmojë në bashkim të forcave kundër manipulimit të informacionit, duke vlerësuar që fushatat dezinformuese paraqesin kërcënim të madh për stabilitetin e Kosovës dhe gjithë Ballkanin Perëndimor, duke përmendur edhe rrezikun nga sulmet



kibernetike. "Fatqësisht as Kosova nuk është kursyer nga këto sulme, të cilat sa vijnë e intensifikohen si rezultat i ndikimit të Rusisë në rajon,

nëpërmjet satelitit të saj - Serbisë. Kjo jo vetëm që është shqetësuese, por paraqet kërcënim aktiv për destabilizim të rajonit tonë", ka thënë Osmani.

Sa i përket nënshkrimit të marrëveshjes së mirëkuptimit mes dy shteteve kundër manipulimit të informacionit nga shtetet e huaja, Allen ka

theksur se qeveritë autoritare manipulojnë informacionin dhe përhapin dezinformata për të ndikuar te njerëzit në mbarë botën për ta ulur besimin në institucione, veçanërisht në ato demokratike. "Siguria dhe stabiliteti në Evropën Jugore dhe Qendrore, veçanërisht në Ballkanin Perëndimor, janë prioritetet kryesore që kam theksuar në çdo pjesë të udhëtimit tim në rajon", ka potencuar Allen.

Ambasadori amerikan në Prishtinë, Jeff Hovenier, ka thënë se nënshkrimi i kësaj marrëveshje ka një rëndësi të veçantë. "Ky është një hap i rëndësishëm drejt promovimit të informacionit të saktë globalisht dhe ndërtimit të një ekosistemi të qëndrueshëm të informacionit në Kosovë", ka thënë Hovenier.

Çeku, Allen dhe Hovenier vizituan lokalitetin arkeologjik në Dresnik

Klinë, 19 maj - Projekti i Ministrisë së Kulturës për trajtimin, mbrojtjen dhe promovimin e lokalitetit arkeologjik të Dresnikut po zbatohet me sukses. "Për ta parë progresin e punës atje, gjatë ditës së djeshme ishin për vizitë ministri Hajrulla Çeku,

nënsekretarja amerikane e shtetit për diplomaci publike, Elizabeth Allen dhe ambasadori amerikan në Kosovë, Jeffrey Hovenier", ka njoftuar MKRS-ja, duke bërë me dije se projekti i cili po zbatohet nga Instituti Arkeologjik i Kosovës dhe ChwB, në fazën e dokumentimit

ka marrë mbështetje edhe nga Fondi i Ambasadorëve për Ruajtjen e Kulturës. "Kjo pasuri kombëtare. krahas konservimit profesional dhe hapjes e prezantimit për vizitorët, do të gënjerojë edhe aktivitet ekonomik për zonën", ka njoftuar MKRS.



Analistët: Zhvillimet rreth Këshillit të Evropës rrezikojnë ta ulin ritmin e integrimit evropian të Kosovës

PRISHTINË, 19 MAJ - Ish-drejtori për Ballkanin Perëndimor në Komisionin Evropian, Pierre Mirel, në një intervistë me "Zërin e Amerikës" tha se mungesa e gatishmërisë së Kosovës për të hedhur hapa drejt themelimit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe vë në pikëpyetje besueshmërinë e saj te partnerët ndërkombëtarë. Moshedhja e hapave për themelimin e Asociacionit e la Kosovën jashtë agjendës në takimin e ministrave të Jashtëm të Këshillit të Evropës të premtën, ndonëse afrimi me këtë organizatë ishte parë si një hap i rëndësishëm për Kosovën e cila është e fundit në rajon në proceset integruese. "Mendoj se nuk ishte veprim i mençur. Nuk është një zhvillim pozitiv. Kjo mund t'ua japë ndjesinë disa vendeve anëtare se pas kërkesës së shprehur me vite e vite për t'iu bashkuar Këshillit të Evropës, papritur Kosova nuk është në gjendje të dorëzojë një projekt, pra jo tekstin përfundimtar, por një projekt në Gjykatën Kushtetuese. Pra disa partnerë mund të pyesin veten se a mund të kenë besim më. Prandaj mendoj se kjo nuk është pozitive", tha ai.

Në muajin prill Kosova mori dritën jeshile nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës për t'u anëtarësuar në këtë mekanizëm, por një pjesë e vendeve anëtare ritheksuan se

kusht për përparimin e Kosovës është hedhja e hapave për Asociacionin. "Kishte disa vende anëtare që kishin pikëpamje të tjera dhe që mendonin se 'në rregull Asociacioni mund të themelohet pas anëtarësimit, por të paktën na tregoni vullnetin tuaj të mirë duke dërguar propozimin në Gjykatë Kushtetuese. Kjo është shenjë e vullnetit të mirë sepse për Këshillin e Evropës një çështje shumë e rëndësishme është trajtimi i pakicave në çdo vend", thotë Mirel.

Qeveria e Kosovës i dërgoi të mërkurën një letër Këshillit të Evropës me zotimin për të hartuar një projekt statut të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe dhe për ta dërguar për interpretim në Gjykatën Kushtetuese deri në fund të muajit maj, ndonëse që më parë udhëheqësit kryesorë evropianë e kishin bërë të qartë se një mundësi e tillë nuk është "as e përshtatshme dhe as e zbatueshme".

Mirel thotë se projekt-propozimi evropian që iu dorëzua Kosovës dhe Serbisë vjeshtë e vitit të kaluar po qëndron në tavolinë tash e disa muaj duke theksuar se kishte mundësi të shumta për ta diskutuar në rast se kishte ndonjë pjesë të përmbajtjes që nuk është e kënaqshme. "Por kjo nuk ndodhi, ndërsa krejt papritur projekt-propozimi nuk



dërgohet në gjykatë dhe dërgohet një letër. Kjo është konfuze në fakt", thotë ai.

Profesori për paqe dhe studime të konflikteve në Universitetin e Dublinit në Irlandë, Gëzim Visoka, i tha "Zërit të Amerikës" se kushtëzime të reja kanë qenë të prishme dhe rëndojnë pozitën ndërkombëtare të Kosovës. "Për të siguruar njohje dhe anëtarësim në mekanizma ndërkombëtarë, miqtë e Kosovës e kanë kushtëzuar Qeverinë e Kosovës që të bëjë kompromise të brendshme. Pra për ta fuqizuar sovranitetin e jashtëm, Kosovës i është kërkuar të zbehë apo dobësojë sovranitetin e brendshëm", thotë

ai. Por Mirel vlerëson se Kosova duhej të bënte lëshime ndaj trysnisë ndërkombëtare për një interes më të madh të saj siç është integrimi evropian. "Një gjë e rëndësishme është që kur një vend është në kërkim, le të themi të sovranitetit të plotë, sepse pesë vende ende nuk e njohin Kosovën, ai vend duhet të sigurohet që çdo element i mundshëm që ndihmon të shfrytëzohet", thotë ai.

Ndonëse vlerëson se zhvillimet e fundit rrezikojnë ta ulin ritmin e integrimit evropian të Kosovës, Visoka është kundër asaj që ai e quan kulturë e kushtëzimeve në diplomaci. "Nuk mendoj se do të

mund të arrihet paqja e qëndrueshme nëpërmjet kësaj kulture të kushtëzimeve dhe trysnisë së njëanshme. Kjo vetëm sa do ta nxisë populizmin, nacionalizmin dhe do t'i acarojë marrëdhëniet ndërmjet palëve dhe ndërmjetësuesve", thotë ai.

Mirel thotë se interesimi i shtuar së fundmi i Bashkimit Evropian për integrimin e Ballkanit Perëndimor duhet të shfrytëzohet nga shtetet e rajonit. Ai shpreh shqetësimin se mungesa e një përparimi më të shpejtë në këtë proces rrezikon të jetë burim i paqëndrueshmërisë në rajon, i cili pastaj edhe mund të shfrytëzohet nga forcat e huaja keqdashëse.

Hamza në Zvicër takohet me bashkatdhetarë: Janë shtyllë e pamohueshme ekonomike

Prishtinë, 19 maj - Kandidati për kryeministër të Kosovës i Partisë Demokratike të Kosovës, Bedri Hamza, po qëndron në Zvicër. Ai ka mbajtur takime me bashkatdhetarë. "I emocionuar dhe i lumtur të shoh bashkatdhetarët tanë që kanë ndërtuar jetën e tyre, plot suksese dhe arrijtë në një vend kaq demokratik dhe gjithmonë për kaq vite, kanë ruajtur traditën dhe dashurinë për atdheun! Të rinj e të reja dhe familjarë që lanë Kosovën në

rrethana të ndryshme, duke u ndarë në dysh me pjesën tjetër për një jetë më të mirë, sot janë zëri ynë në botë, janë shtyllë e pamohueshme ekonomike dhe mbështetës në rrugën e pakthyeshme evropiane të Kosovës. Krenar me historitë e suksesit që ata na e tregojnë çdo ditë dhe me mbështetjen e pakursyer për vizionin tonë, për ta drejtuar vendin, drejt një të ardhme, që secili e meriton dhe kërkoni!", ka shkruar Hamza në "Facebook".



Takimi Kurti - Allen, kryeministri shpreh shqetësimin për kërcënimet nga Serbia dhe lënien në liri të Radoiçiqit

PRISHTINË, 19 MAJ - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka pritur të dielën në takim nënkretaren e Departamentit të Shtetit amerikan për Çështje dhe Diplomaci Publike, Elizabeth Allen. Ai i uroi mirëseardhje nënkretares Allen, e cila po e viziton Kosovën për herë të parë. "Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë aleatja, mikja dhe partnerja jonë historike, aktuale dhe e së ardhmes, andaj presim që ta fuqizojmë dhe thellojmë bashkëpunimin bilateral, veçanërisht në fushën e ekonomisë dhe tregtisë", ka theksuar kryeministri në fillim të takimit, teksa shprehu mirënjohjen dhe falënderimin për ndihmën, rolin dhe kontributin e Shteteve të Bashkuara për çlirimin, pavarësimin dhe zhvillimin e Republikës së Kosovës. Gjatë bashkëbisedimit, kryeministri Kurti e njohu nënkretaren Allen me zhvillimet e fundit në vend, me progresin e shënuar në vitet e fundit në sundimin e ligjit dhe



indikatorët ekonomikë dhe demokratikë, me politikat sociale që mbështesin gratë dhe fëmijët, reformën në arsim me qëllim ndërlidhjen e arsimit me tregun e punës dhe me politikat dhe investimet në sektorin e energjisë.

Për këtë të fundit, ai falënderoi nënkretaren Allen për mbështetjen e vazhdueshme të Shteteve të Bashkuara përmes USAID-it në përgatitjen dhe përmbylljen e suksesshme të ankandit të parë të energjisë solare dhe programit Kompakt

të Korporatës së Sfidave të Mijëvjeçarit (MCC) i cili hyri në fuqi në fund të muajit të kaluar. Në takim kryeministri ngriti brengën e tij mbi kërcënimet e vazhdueshme të Serbisë ndaj Kosovës, edhe për faktin që autori dhe lideri i grupit të

terroristëve dhe paramilitarëve që kryen sulmin e 24 shtatorit 2023 në Banjskë, Millan Radoiçiq, vazhdon të jetë i lirë në Serbi.

U diskutua edhe për raportet Kosovë - Serbi dhe procesin e dialogut të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian. Për këtë çështje, kryeministri Kurti theksoi rëndësinë e zbatimit të plotë e të pakushtëzuar të Marrëveshjes Bazike dhe aneksit të saj.

Sa i përket rrugëtimit të Kosovës në integrimet evropiane, ai shprehu keqardhjen e tij që Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës nuk pati gatishmëri ta përfshijë Kosovën në agjendën e votimit të 17 majit, duke marrë parasysh se Kosova i ka plotësuar të gjitha kriteret e anëtarësimit në këtë organizatë, siç është konfirmuar edhe nga instancat e kësaj organizate, përfshirë Asamblenë Parlamentare, dhe kur dihet që anëtarësimi ynë do t'i kontribuonte forcimit dhe promovimit të të drejtave të njeriut.

Shkarkohet kryetari i Sindikatës së Policisë së Kosovës, Imer Zeqiri

PRISHTINË, 19 MAJ - Sindikata e Policisë së Kosovës ka mbajtur të dielën Kuvendin e Përgjithshëm. E vetmja pikë në rendin e ditës ishte shkarkimi i kryetarit të Sindikatës, Imer Zeqiri. "Sot më 19.05.2024 është mbajtur Kuvendi i Përgjithshëm i Jashtëzakonshëm ku ishte thirrur nga Këshilli Drejtues i SPK-së bazuar në Ligjin mbi Organizimin Sindikal dhe Statutit të Sindikatës së Policisë së Kosovës, me të vetmen pikë të rendit të ditës për votimin e shkarkimit të kryetarit të SPK-së Imer Zeqiri. Në këtë Kuvend të pranishëm ishin 60 delegatë të

Kuvendit nga gjithsej 73 delegatë që ka ky Kuvend dhe në mënyrë unanime me vota të hapura të gjithë votuan pro shkarkimit të kryetarit të Sindikatës së Policisë së Kosovës Imer Zeqiri. Kuvendi i Përgjithshëm i SPK-së i siguron të gjithë anëtarët e Sindikatës së Policisë së Kosovës se kjo sindikatë do të vazhdojë punën pa pengesa deri në Kuvendin e ardhshëm duke mbrojtur të drejtat e çdo punonjësi të Policisë së Kosovës, ngritjen e mirëqenies dhe kushteve të punës", është bërë me dije në njoftimin e Sindikatës së Policisë së Kosovës.



Thaçit i shkojnë prindërit për vizitë në Hagë

Prindërit e ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, kanë shkuar të dielën në Hagë për ta vizituar djalin e tyre, i cili po mbahet në qendrën e

paraburgimit të Gjykatës Speciale. Thaçi ka hyrë në vitin e katërt të qëndrimit në paraburgim. Atje u dërgua që nga nëntori i vitit 2020, së

bashku me tre ish-udhëheqës të tjerë politikë e ushtarakë të UÇK-së, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi.

“Ndryshimi i qeverisjes në nivelin qendror të bartet edhe në nivelin lokal”

PRISHTINË, 14 MAJ - Nën drejtimin e Kryesueses së Këshillit, Rinë Zhita, të dielën është mbajtur mbledhja e rregullt e Këshillit të Qendrës të Lëvizjes Vetëvendosje në Prishtinë.

Para delegatëve të pranishëm foli kryetari i LV-së, njëherësh kryeministër i vendit, Albin Kurti, i cili paraqiti një përmbledhje të përgjithshme mbi situatën politike në vend, proceset, sfidat dhe të arriturat e ekzekutivit gjatë këtij mandati qeverisës.

Përveç çështjeve të karakterit nacional, Kurti foli edhe për aspektet komunale dhe organizative. “Qendra e Prishtinës e Lëvizjes Vetëvendosje, si qendra më e madhe e organizatës sonë, ka rëndësi të veçantë andaj edhe përkushtimi dhe mobilizimi

rreth qendrës e për qendrën duhet të jetë i veçantë e sa më i madh”, ka thënë Kurti.

Me një fjalë rasti të pranishmëve iu drejtua edhe kryetari i Qendrës së Prishtinës, Arben Vitia, i cili foli mbi punën e përgjithshme të të gjitha strukturave të Qendrës së Prishtinës, përfshirë Kryesinë e Qendrës, Grupin e Asamblistëve, GVV-në e RVV-në, nënkomitetet dhe sekretariatet e qendrës.

Vitia potencoi nevojën për angazhim dhe mobilizim shtesë në mënyrë që ndryshimi i qeverisjes, i ndodhur tashmë në nivelin qendror, të bartet edhe në nivelin lokal.

Mbi çështjet organizative dhe aktivitetin e ndodhur në Qendrën e Prishtinës në periudhën në mes të dy mbledhjeve të Këshillit të

Qendrës, si dhe planet dhe projektet e planifikuara e që do të realizohen në të ardhmen e afërt, foli sekretari i Qendrës së Prishtinës, Egzon Azemi. “Ka shtim të aktiviteteve e të takimeve në pika, në lagje e fshatra të qytetit, siç ka edhe rritje të dinamikës së angazhimeve në kryesi të qendrës dhe në çdo strukturë tjetër mbështetëse”, ka thënë Azemi.

Mbi punën e Grupit të Asamblistëve dhe zhvillimet politike në Prishtinë foli drejtuesi i Grupit të Asamblistëve, Gëzim Sveçla. Pasi numëroi disa nga punët e bëra nga asamblistët e LV-së në Kuvendin Komunal, ai foli mbi gjendjen e përgjithshme në kryeqytet, e cila, sipas tij, është më e rëndë se asnjëherë më parë. “Nepotizmi, klientelizmi,



keqpërdorimi dhe abuzimi me të mirat publike në komunën e Prishtinës është në nivele alarmante”, ka potencuar Sveçla.

Arratisja e Sekiraqës, Haxhiu: Ky rast ngre dyshime për përfshirje të gjyqësorit në korrupsion

PRISHTINË, 19 MAJ - Ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka reaguar pas arratisjes së Enver Sekiraqës, duke thënë se dikush që është i njohur edhe për publikun, se lëre më për gjyqësinë e prokurorinë për krime të rënda e përsëritje të tyre, lihet herë në arrest shtëpiak e pastaj në liri, deri në një aktvendim tjetër, kësaj arratiset tërësisht.

“Kjo ndodhi edhe me Enver Sekiraqën, i cili ishte dënua ditë më parë me burgim prej 25 vitesh për vrasjen e policit të Policisë së Kosovës. Kjo qasje joprofesionale e gjyqtarëve në shumë raste po rezulton me trashje të krimit. Herë po manifestohet me vrasje e herë me arratisje të tërësishme. Dhe ky nuk është gabim i izoluar, por veprime të shpeshta që po shprehërohen me mendësi të gjykimet e të cilat po përkthehen në stimulim të kriminelëve”, ka shkruar Haxhiu në Facebook. Ajo ka thënë se caktimi i masës së



arrestit shtëpiak e mosndryshimi i asaj mase është skandal i madh. “Madje kjo arratisje indirekte ishte paralajmëruar në seancën e shpalljes së aktgjykimit për Sekiraqën, kur në seancë u njoftua

se do t'i ndërpritej me një vendim tjetër të gjyqësorit në të ardhmen. Duket që sistemi ynë gjyqësor, për shkak të përvojës së mbrapshtë në mungesë të dënimt të peshaqe të mëdhenj, po vazhdon të mos

këndellet nga gjendja e vet, duke toleruar kështu arratisje e përsëritje të veprave kriminale. Kjo gjë është tejet shqetësuese dhe do të duhej të shërbente si alarm jo vetëm për rastin specifik, por për të

tilla raste në përgjithësi”, është shprehur ajo.

Ministria Haxhiu ka thënë se sistemi gjyqësor ekziston pikërisht për t'u dhënë qytetarëve drejtësi e siguri, jo frikë dhe panik. “Ata duhet të jenë në anën e ligjit, të të dënuarëve dhe, mbi të gjitha, të interesit publik, jo në anën krimi, të fortëve e klaneve mafioze. Ky rast, përveç të tjerash, ngre dyshime edhe për përfshirje në korrupsion, prandaj duhet të ketë një hetim profesional dhe përgjegjësi nga ata që mundësuan këtë arratisje”, ka deklaruar Haxhiu. Policia e Kosovës ka konfirmuar se Enver Sekiraqë është arratisur pas ndryshimit të masës së sigurisë, pasi Gjykata e Apelit dy ditë më parë kishte vendosur ta kthejë në paraburgim.

I akuzuari Enver Sekiraqë më 3 maj 2024, për herë të tretë pas kthimit të rastit në rigjykim, u dënua me 25 vite burgim për njëjtë në vrasjen e policit Tritum Riza.

Kupchan: Përgatitja për themelimin e Asociacionit, vendim i rëndë për Kosovën

PRISHTINË, 19 MAJ - Themelimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe vazhdon të jetë kërkesë e vazhdueshme e Bashkimit Evropian ndaj Kosovës. Një kërkesë e tillë u bë edhe më e zëshme si kushtëzim për Republikën për t'u anëtarësuar në Këshillin e Evropës.

E sipas profesorit amerikan të Marrëdhënieve Ndërkombëtare, Charles Kupchan, nisma për themelimin e Asociacionit është e rëndë për qeverinë e Kosovës. “Mendoj se vendimi për përgatitjen dhe implementimin e Asociacionit është vendim i rëndë dhe i dhimbshëm për

Qeverinë e Kosovës. Është, siç themi ne në ShBA, sikur ta nxjerrësh dhëmbin. Është i dhimbshëm, prandaj njerëzit nuk duan ta bëjnë. Çfarë shohim këtu është që BE-ja, Këshilli i Evropës krijonë nxitje për të bërë ato vendime të rënda, duke ofruar levë politike, që Kurti të thotë se nëse duam pranimin në Këshillin e Evropës, duhet të bëjmë këtë”, ka deklaruar ai për televizionin.

Sipas tij, faktori ndërkombehtar do të veprojë ngjashëm edhe ndaj Serbisë, duke rritur presionin për ta pranuar Marrëveshjen e Ohrit. E pas sulmit të 24 shtatorit në

Banjskë, Milan Radoiçiq ende po vazhdon të mbetet i lirë. Profesi amerikan vlerëson se sjellja para drejtësisë e Radoiçiqit do të marrë kohë. “Te dyja palët, të dyja qeveritë, kanë shumë punë për të bërë, pajtime për të bërë. Duhet ta shohim Serbinë të bëjë më shumë, që të kërkojë llogari nga ata që kanë qenë përgjegjës për akte të dhunës dhe për aktivitetet të tjera ilegale. Kjo është pjesë e procesit afatgjatë për t'i shtyrë Kosovën dhe Serbinë drejt marrëveshjes finale dhe për t'u bërë presion palëve të marrin vendime të vështrira”, ka thënë ai.



Kurti për reformën e asistencës sociale: Do të krijojë barazi dhe do të nxisë punësimin

PRISHTINE, 19 MAJ - Qeveria e Kosovës e ka paraqitur planin për reformim të skemës së asistencës sociale në Kosovë. Projekti i reformave është mbështetur dhe financuar prej Bankës Botërore. Kjo nënkupton që të gjithë qytetarët e Kosovës do të mund të kyçen në platformën shtetërore eKosova prej 18 majit për të kuptuar nëse kualifikohen për asistencë sociale. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se skema e re do të krijojë barazi dhe do ta nxisë punësimin, duke bërë vlerësimin e varfërisë në secilën familje. Ai e ka konsideruar diskriminuese skemën aktuale që e përjashton një familje nga asistencë pasi një fëmijë të mbushë pesë vjeç, apo sapo një anëtar i familjes të punësohet, pavarësisht se për çfarë periudhe. "Qysh nga ky moment çdo familje në republikën tonë, e cila ka të ardhura më të ulëta

se 100 euro për anëtar, për muaj, mund të qaset në eKosova dhe të aplikojë për t'u bërë pjesë e pilotimit të skemës së asistencës sociale", ka thënë Kurti. Ministri i Financave i Kosovës, Hekuran Murati, ka thënë se procesi i pilotimit për reformë do të ndihmojë në hartim të projektligjit të ri për asistencën sociale dhe do t'u mundësojë shumë familjeve të përfitojnë nga skema sociale deri në miratim të ligjit të ri. Ai ka thënë se me skemën e re anëtarët e familjes do të ndahen në dy kategori: në ata që mund të punojnë dhe ata që nuk mund të punojnë. Te kategoria e atyre që nuk mund të punojnë i ka përmendur: prindërit e vetëm që kanë fëmijë nën moshën 18-vjeçare, personat nën aftësi të kufizuara, personi që është në arsim të vazhdueshëm deri në moshën 26-vjeçare, gratë shtatzëna deri në periudhën që

e parasheh ligji për pushimet e lehonisë, njëri nga prindërit që kujdeset për fëmijën deri në 12 muaj, anëtarët e familjes nën moshën 18-vjeçare ose personat mbi moshën 65-vjeçare, dhe të gjithë anëtarët e tjerë të familjes që për një arsye ose tjetër konsiderohet që mund të mos jenë të aftë për punë. Murati ka paralajmëruar që Ministria e Financave do të bashkëpunojë nga afër me Agjencinë e Punës, që personave që mund të punojnë dhe nuk janë të punësuar, t'u ofrohen vende pune dhe trajnime të nevojshme në mënyrë që një familje të dalë gradualisht nga varfëria. "Ky test i varfërisë e bën testimin nëse familja ka të ardhura apo jo, të ardhura formale, dhe në ato të ardhura hyjnë të ardhurat nga punësimi, nga shitja e ndonjë prone, të fituara nga qiraja, nga skemat e pensioneve, dhe të gjitha të ardhurat nga skemat

shtetërore". Në familjet që kanë anëtarë me aftësi të kufizuara nuk do të vlejë ky testim. "Deri më tani, nëse një familje ka pasur të ardhura gjatë muajit, për shembull, nëse dikush është angazhuar si komisionar për zgjedhje, për shkak se ka marrë 100 euro, është larguar prej skemës. Tani nuk largohet, por bëhet kalkulimi apo logaritja e të hyrave dhe për atë muaj ripërshtaten të ardhurat. Ripërshtatja vazhdon tre muaj për të parë nëse punësimi ka qenë i qëndrueshëm". Murati ka thënë se pasi një familje të kalojë fazën e parë - pra të ketë të hyra më të vogla se 100 euro për një anëtar të familjes në muaj - më pas do të bëhet edhe testi i të ardhurave, të pasurisë, vlerësimi i asetëve dhe testi i gjërave materiale. Më vonë do të zhvillohen vizita në terren nga punëtorë të qendrave për punë sociale dhe

në fund një komision në Ministri të Financave do ta bëjë vlerësimin. Kosova nuk ka të dhëna të përditësuara për varfërinë në vend. Të fundit, të përpiluara nga Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) dhe Banka Botërore, janë të vitit 2017. Sipas tyre, 18 për qind e popullsisë së Kosovës jeton në varfëri, përkatësisht me rreth 2 euro në ditë, kurse 5.1 për qind në varfëri të skajshme apo me më pak se 1.5 euro në ditë. Asistencë sociale - nga 60 deri në 180 euro në muaj, varësisht numrit të anëtarëve - u jepet familjeve me kushte të vështira financiare dhe që nuk kanë asnjë anëtar të punësuar. Me mbi 1.7 milion banorë, Kosova ka pagën më të ulët minimale në Evropë, që sillet nga 130 deri në 170 euro në muaj. Paga mesatare në vend është 520 euro.



Prodhuesit vendorë ankohen për mospërkrahje nga shteti



PRISHTINE, 19 MAJ - Prodhuesit vendorë në Kosovë janë ankuar për mungesë të përkrahjes nga ana e qeverisë. Ata kanë kërkuar nga shteti t'i marrë më shumë parasysh prodhuesit vendorë dhe t'i stimulojë me masa më të favorshme. Përfaqësues të bizneseve kanë theksuar se ka rritje të prodhimit në vend, mirëpo jo edhe mbështetje ekzekutive. Stimulimi me subvencione, apo masa të tjera, është duke munguar nga ana e qeverisë të prodhuesit vendorë. Menaxheri i fabrikës për prodhimin e transformatorëve, Andi Selimi, derisa ka konsideruar se këto panairë janë

të rëndësishme për ta promovuar biznesin e tyre dhe shkëmbyer ide me të tjerët, është shprehur se presin më shumë ndihmë nga qeveria. Madje, në disa raste, ai thotë se po harrohen nga vetë shteti, duke përmendur këtu një grant nga Ministria e Industrisë, Tregtisë dhe Ndërmarrësisë, të cilët nuk kanë mundur të marrin pjesë për shkak të kodit. "Ne jemi prodhuesit e vetëm në Kosovë që prodhojmë transformatorë. Fabrikën e kemi në Janjevë. Mbështetje të qeverisë nuk është se kemi pasur djekë konkrete. Kemi marrë pjesë në disa grante, mirëpo nuk është se kemi pasur ndonjë përkrahje të

drejtëpërdrejtë nga qeveria", ka thënë ai. Se duhet të ndihmohen më shumë bizneset thotë edhe përfaqësues i një kompanie me shirita ngjites në Kosovë, i cili prodhon mbi 50 lloje të shiritave dhe ngjites, Martir Demiri. Madje ai thotë se s'fidë është edhe mungesa e fuqisë punëtore pas liberalizimit të vizave. "Ne kemi filluar vitin e kaluar me prodhim, sivjet shihet se ka rritje dukshëm të kërkesave dhe klientëve. Sigurisht se duhet të përkrahët prodhuesi vendor në mënyrë që të mund t'i kontribuojmë vendit tonë. Eksportojmë në Itali, Francë, Gjermani dhe Zvicër", ka thënë Demiri. (kp)

Intervista e Fidel Castro më 1961, në prag të kërcënimit bërthamor

Nga: Myles BURKE / BBC

Më 26 qershor 1961, në një fermë jashtë Havanës, Robin Day i programit Panorama të BBC-së u ul pranë 34-vjeçarit Fidel Castro, për të folur rreth ndryshimeve që kishin ndodhur në ishull, qëkur ai kishte udhëhequr revolucionin për të përmbysur diktatorin e Kubës, Fulgencio Batista.

Castro ishte intervistues i këndshëm, në disa raste bishtues, i etshëm për t'i lënë përshlytje gazetarit të BBC-së se si politika e Reformës Agrare – të cilën ai e kishte nënshkruar pak më shumë se dy vjet më parë – po përmirësonte jetën e kubanëve, dhe gjithashtu për të folur për dëshirën e tij për marrëdhënie paqësore me ShBA-në.

Pak gjëra në intervistën në dukje të veçantë, tregonin se sa e vështirë dhe e rrezikshme po bëhej situata midis Kubës dhe ShBA-së.

Day ishte njëri nga një numër i gazetarëve të ftuar, ndërsa udhëheqësi revolucionar ishte në disponim pozitiv teksa ata bënin turne nëpër fshatrat e Kubës.

"Eshhtë orator i lindur me rrjedhë të pafund të fjalëve", raportoi Day duke rrëfyer se Castro i kishte lënë mjaft përshlytje teksa grupi i fliste për vizionin e tij për vendin.

"Nuk duket të konsiderohet si i krisur apo palaço. I la përshlytje edhe gazetarit të New York Times-it, si njëri mendjeprehtë, erudit dhe i zoti. Eshhtë magjeps, kudo që shkon", tha Day. Castro donte t'ua tregonte atyre mbështetjen në mesin e popullit kuban, ndaj më parë i kishte çuar në një fermë të re shtetërore ku punëtorët e plantacioneve ishin grumbulluar për të biseduar me të dhe ai i kishte inkurajuar gazetarët që t'i pyesnin ata.

Për udhëheqësin kuban, qëllimi kryesor i revolucionit ishte fuqizimi i të varfërve të ishullit dhe përmirësimi i kushteve të tyre të jetesës. Kjo ambicie ishte mishëruar në Aktin e Reformës Agrare të cilin Castro e nënshkroi në ligj në maj të vitit 1959, duke përmbysur modelet shekullore të shfrytëzimit në Kubë.

Para revolucionit, zona të mëdha të tokave kubane gjendeshin në duart e disa familjeve të pasura dhe kompanive të huaja shumëkombëshe, si Coca-Cola dhe United Fruit. Shumica e fshatërve kubanë

punonin si punëtorë për ta shpeshherë në kushte shtypëse, ose luftuan për të mbijetuar si fermerë fshatarë në parcela të pakta toke, të rrezikuara nga dëbimet e paligjshme.

Kjo pabarazi e ashpër kishte rrethosur varfërinë në ishull dhe kishte siguruar terren pjellor për rrethjet e idealeve prapa revolucionit të Castro. Ligji i Reformës Agrare ndaloj gjithë pronësinë e huaj të tokës dhe u konfiskuan pronat me mbi 1000 hektarë.

Këto toka ishin rishpërndarë, disa u kthyen në komuna shtetërore, të tjerat u dhanë rreth 200 mijë fshatërve që morën tokat e tokave. Castro me sa duket e kishte zemëruar edhe nënën e vet duke konfiskuar disa nga pasuritë e familjes në Finka Las Manakas.

Castro donte t'i tregonte ekipit të gazetarëve se ai ligj, i cili sot mbetet baza e modelit bujqësor të Kubës, po ndryshonte për të mirë jetën e kubanëve të zakonshëm.

"Kenë udhëtuar nëpër Kubë, çfarë keni parë gjatë udhëtimit [tuaj]? Të gjithë punojnë, të gjithë janë të lumtur. A i keni parë vështirësitë ekonomike?" – i tha ai Dayt.

Por, përtej miqësisë sipërfaqësore në turne, situata nuk mund të ishte më e tensionuar.

Ligji e kishte vënë qeverinë e Castro në mosmarrëveshje me Uashingtonin dhe udhëtimin ishte organizuar si pjesë e ofensivës për të lënë përshlytje, në përpjekjen për të ndryshuar situatën e përkeqësuar midis dy kombeve.

Ngritja e papritur e Castro në pushtet kishte shkaktoar probleme të thella ndërkombetare për ishullin e vogël të Karaibeve. Qeveria amerikane, në veçanti, ishte fuqimisht kundër eksperimentit socialist të Kubës. Diktatura ushtarake e Batistas, ndonëse ishte e korruptive, shtypëse dhe thellësisht jopopullore për kubanët, kishte qenë ashiqare pro-ShBA-së dhe regjimi shihjej si aleat i bizneseve amerikane që zotëronin pjesën më të madhe të industrisë së vendit.

"Batista konsiderohej njeriu më i mirë i ShBA-së në Kubë, i cili më të vërtetë zbatoi ligjin për të mirën e kompanive amerikane", tha për BBC Witness History, më 2016, diplomati dhe studiuesi kuban Carlos Alzugaray. "Për shembull, ai dhe kabineti i tij merminin dy mijë dollarë në muaj nga mafia, për t'u lënë të lirë të bëjnë çfarë të duan për kazinotë dhe prostitucionin në Kubë".



Kur qeveria e re revolucionare merr pushtetin, ajo i kishte shtetëzuar këto biznese amerikane, pa kompensim, duke hequr bazën e tyre në ekonomi. Si kundërpërgjigje, në vitin 1960 ShBA-ja kishte vendosur embargon tregtare – e cila mbetet ende në fuqi sot – duke shpresuar se mungesat dhe uria do ta destabilizojnë regjimin e ri. Por, derisa ShBA-ja mbylli tregtinë e saj me Kubën, qeveria e Castro e kompensoi duke u kthyer të një partner i ri tregtar – te superfuqia rivale e ShBA-së, Bashkimi Sovjetik. Më pas, në fillim të vitit 1961 – gjashtë muaj para intervistës së BBC-së – ShBA-ja ndërpreu të gjitha marrëdhëniet diplomatike me Havanën. Kur këto masa nuk arritën të rrezonin qeverinë e re socialiste, CIA vuri në fuqi planin për të cilin kishin punuar që nga fillimi i vitit 1960.

Me miratimin e presidentit Eisenhower, CIA kishte trajnuar dhe financuar në mënyrë të fshehtë rreth 1400 kubanë të cilët ishin larguar nga shtëpitë e veta, qëkur Castro kishte marrë pushtetin. Ata planifikuan ta zbarkonin këtë forcë pushtuese në Gjirin e Derrave, 100 mijë (161 kilometra) në juglindje të Havanës, duke besuar se kjo do të niste kryengritjen popullore kundër Castro. Presidenti i ri i ShBA-së, John F. Kennedy, e dha miratimin për këtë projekt. Doli të jetë vlerësimi më i gabuar dhe më dramatik; sulmi ishte dështim i tmerrshëm dhe pushtuesit u dorëzuan pas më pak se 72 orëve; më shumë se 1000 prej tyre u zunë robër.

Pak më shumë se dy muaj më vonë, Castro rrinte ulur duke folur me një grup të gazetarëve që përshininin amerikanët, të vetëdijshëm se qeveria e tyre po përpiqej të mënyrë aktive që ta rrezonte.

Dhe, jo gjithçka kishte qenë e thjeshtë për ata gazetarë amerikanë. Castro i detyroi të

shkojnë në konferencë shtypi në mesnatë – e cila zgjati deri në orën 3:15 të mëngjesit, përpara se të fillonte turneu në orën 6:00 të mëngjesit. Turneu përshinte qëllimisht skenat e sulmit katastrofik në Gjirin e Derrave – duke përfshirë rrënojat e një aeroplani të rrëzuar B26, të ofruar nga ShBA-ja për pushtuesit, si dhe një shtëpi e shkatërruar nga një bombë nga forcat sulmuese, të cilën Castro u zotua ta ruante si memorial.

Por, Castro ishte i etur që në intervistë që ta de-eskalonte situatën gjithnjë e më të paqëndrueshme me ShBA-në, dhe për të vendosur marrëdhëniet më normale. Kur u pyet nëse ishte neutral në Luftën e Ftohtë, apo nëse ishte në linjë me fuqitë komuniste, ai u përgjigj: "Pse mendoni për luftën? Mendoj se gjëja më e mirë për paqen është të mendosh për paqen. Jam me paqen".

Ishte më bishtues kur Day e pyeti se kur do të ketë Kuba zgjedhje demokratike, duke thënë: "I kemi pyetur njerëzit dhe ata thonë se nuk duam politikë tash mëgjë po punojmë". Më parë, për BBC News, në një intervistë në janar 1959 ai kishte thënë se mendonte se "aty kah 18 muaj do të kemi zgjedhje të lira – për më pak se një vit".

Tani e riformuloi nocionin e demokracisë duke mohuar të drejtën për të votuar në zgjedhjet qeveritare, të drejtën që punëtorët të kenë kontroll mbi jetën dhe punën e tyre të përditshme.

"Besoni se këtu nuk ka demokraci? Ju siguroj se ka më shumë demokraci sesa në ShBA", tha ai. "Sepse, këtu, ajo çfarë ishte një punëtor, çfarë ishte një fshatar, kundërshtojë nga autoriteti përmes pronarëve të tokave. Tani ata e organizojnë punën, e organizojnë kooperativën. Njeriu më i lirë që mund të gjejsh në të gjitha Amerikat është burri kuban".

Por pavarësisht premtimeve të Castro, zgjedhjet e lira dhe të ndershme nuk do të realizohen kurrë për Kubën.

Në atë kohë Castro kishte vendosur tashmë sistemin njëpartak, duke dërguar qindra njerëz në burg si të burgosur politikë. Gjatë viteve 1960, u bë gjithnjë e më repressiv dhe intolerant ndaj çdo kritike, me çka e mbyti shtypin të lirë dhe mijëra homoseksualë, disidentët dhe të tjerë që konsideroheshin si "të padëshiruar", u dërguan në kampet e punës së detyruar.

Përparimi që bëri Castro duke sjell arsim dhe kujdes falas shëndetësor për të gjithë kubanët, u zbeh në të njëjtën kohë nga shtypja sistematike e lirive të tyre themelore.

"Që nga revolucionin, për kubanët u përmirësua qasja në shërbimet publike, si shëndëtesia dhe arsimi, dhe për këtë lidheship duhet duartëruar. Megjithatë, pavarësisht këtyre arritjeve në fushat e politikës sociale, mbretërimi 49-vjeçar i Fidel Castro u karakterizua nga shtypja e pamëshirshme e lirisë së shprehjes", ka thënë pas vdekjes së Castro në vitin 2016, drejtoreja e Amnesty International në Amerikë, Erika Guevara-Rosas.

Në fund të fundit, udhëtimi i gazetarëve do të bënte pak gjëra në ndryshimin e trajektoreve në të cilën të dy vendet ishin mbyllur.

Pas dështimit të Gjirit të Derrave, pesë muaj pas intervistës në BBC, presidenti Kennedy e miratoi Operacionin Mongozio, një fushatë të fshehtë ku operativët e CIA-së dhe të mërguarit kubanë kryen një seri sabotazhesh në industrinë dhe tokën bujqësore të ishullit, si dhe tentativën për vrasjen e Castro dhe të zyrtarëve të qeverisë.

Kjo e bindi liderin kuban se ai kishte nevojë për mbështetjen sovjetike dhe, duke besuar se ShBA-ja do të tentonte një pushtim tjetër, ra dakord të lejonte Bashkimin Sovjetik të vendoste raketat bërthamore në ishull – vetëm 90 mijë (145 kilometra) nga Florida.

Ky vendim do të shërbente për të shkaktoar përplasjen mbi Kubën, midis dy superfuqive, gjë që do të çonte në krizën e raketave kubane të vitit 1962 dhe, siç tha ish-korrespondenti i BBC-së në Moskë, Allan Little në vitin 2002, "që brenda disa ditëve do ta sjell botën në afër luftës bërthamore sesa ka qenë më parë apo edhe sot". /Telegrafi/

Ballafaqimi i realitetit diktatorial: Regjisori Mohammad Rasoulof arratiset nga Irani



Nga: Philip OILTERMANN /
The Guardian
Përkthimi: Telegrafi.com

Regjisori iranian Mohammad Rasoulof, i shpëtoi burgimit të pashmangshëm në Iran, duke shmangur që të gjitha pajisjet e gjurmueshme elektronike dhe duke ecur në këmbë nëpër kufirin malor, ka thënë regjisori në një intervistë ekskluzive për ditoren Guardian.

Por, edhe pse ka gjetur strehë në Gjermani dhe është optimist për pjesëmarrjen në premierën e filmit të tij në Kanë, në javën e ardhshme – për të cilin gati sa nuk vuajti tetë vjet burg – Rasoulof tha se pret të kthehet “shumë shpejt” në vendin e vet dhe të ballafaqohet me dënimin. Duke folur përpara premierës në Festivalin e Filmit në Kanë, të filmit të tij Fara e fikut të shenjtë, regjisori i pavarur i vlerësuar me shumë çmime tha se situata e tij ligjore e la “pa zgjedhje”, pos që të largohet nga republika teokratike islamike, sepse ai ishte përcaktuar që të vazhdojë ta tregojë historinë e njerëzve të saj në film.

“Misioni im është të jem në gjendje të përcjellë narrativat e asaj që po ndodh në Iran, si dhe për situatën në të cilën kemi

ngecur si iranianë”, tha Rasoulof në një video-telefonatë nga vendndodhja e pazbuluar në Gjermani. “Kjo është ajo që nuk mund ta bëj në burg”.

Një nga kineastët kryesorë të gjallë të Iranit, Rasoulof dy herë ka vuajtur në burgjet iraniane, disa prej të cilave në izolim. U dënua për filmim pa leje në vitin 2010 dhe përsëri në vitin 2020 për filmin e tij Burri me integritet – për të cilin autoritetet iraniane thanë se është “marrëveshje kundër sigurisë kombëtare dhe propagandë kundër sistemit”.

Pasi iu hoq pasaporta në vitin 2017, iu dha çmimi kryesor në festivalin e Berlinit më 2020 – në mungesë – për filmin e tij Nuk ka ligësi.

Filmi i fundit i Rasoulofit, i cili premierën do ta ketë në Kanë më 24 maj, tregon historinë e gjyqtarit hetues i cili përballet me paranojë përgjatë trazirave politike në Teheran.

Pas vdekjes në vitin 2022, të Mahsa Aminit në paraburgim – të gruas 22-vjeçare kurdo-iraniane e cila u arrestua pas dyshimit se nuk e mbante siç duhej shaminë islame – Republika e Azisë Perëndimore përjetoi protesta në shkallë të gjerë kundër institucionit klerik i cili sundon me Iranin që nga viti

1979.

Duke e zhvendosur fokusin e filmave të vet të fundit nga sistemi shoqëror i Iranit në përgjithësi tek individët të cilët i rezistojnë shtypjes, Rasoulof tha se e dinte se do të merrte dënimin më ndëshkues sesa me filmat e mëparshëm.

Autoritetet e akuzuan për realizimin e filmit të tij pa marrë licencë nga autoritetet përkatëse – krahas akuzave të tjera se aktorët gra nuk e mbanin hixhabin siç duhet dhe se ishin filmuar pa hixhab, tha në një letër avokati i tij Babak Paknia.

Duke përfshirë burgimin, gjobën, konfiskimin e pronës si dhe dënimin me fshkullim për shishet e verës të cilat u gjetën nga policia gjatë bastisjes në banesën e tij, dënimin që rezultoi ishte më i ashpri që i është dhënë ndonjë regjisori në Iran. “Kam shkruar shumë projekte kur isha në burg dhe gjithmonë e kam ndier se nëse shkoj në burg për vite të tëra, nuk do ta kem forcën apo aftësinë për t’i bërë këta filma”, tha Rasoulof. “Pra, së pari duhet t’i bëj dhe më pas është gjithmonë ajo koha për t’u kthyer dhe për të shkuar në burg”.

“Në mendje e kam idenë se do të kthehem shumë shpejt, por mendoj se ky është rasti i të

gjithë iranianëve të cilët janë larguar nga vendi”, shtoi ai. “Që të gjithë e kanë valixhen gati”. Edhe pse pati katër muaj pritje midis dënimit të tij me burg – të shpallur për herë të parë nga një gjykatë në Teheran në janar dhe dërgimit të tij për zbatim këtë muaj – Rasoulof tha se kishte hapësirë prej orëve kur duhej të vendoste nëse do të qëndrojë në Iran apo do të largohet.

Me këshillën e një mikui, e ndërpreu gjithë komunikimin me celular ose kompjuter dhe u nis drejt kufirit, duke kaluar në këmbë përmes një rruge sekrete. “Ishte ecje prej disa orëve, rraskapitëse dhe shumë e rrezikshme që duhej ta bëja me një udhërrëfyes”, kujton Rasoulof, teksa flet me ndihmën e përkthyesit.

Pas rrugimit, u fsheh në një shtëpi të sigurt. “Më duhej të qëndroja atje përpara se të më bartnin në një qytet dhe prej andej në një vend ku mund të kontaktoja autoritetet gjermane”. Autoritetet kulturore në Gjermani ndihmuan në konfirmimin e identitetit të regjisorit dhe Ministria e Punëve të Jashtme ia dha dokumentet që mundësonin udhëtimin për në Evropë. Vetëm me mbërritjes së tij në Gjermani, arratisja e Rasoulofit u bë publike nga

avokati.

I pyetur nëse Ministria e Jashtme Gjermane kishte ndihmuar udhëtimin e Rasoulofit në Evropë, një zëdhënës tha se nuk mund të komentojë për rastet individuale, duke shtuar: “Qeveria federale nuk do të zmbarsë përpjekjet për të mbështetur shoqërinë e guximshme civile të Iranit”.

Edhe pse mbetet pa pasaportë, tha se autoritetet gjermane dhe franceze janë aktualisht në bisedime për ta lejuar që të udhëtojë në festivalin e filmit në Azur – përpara premierës të së premtes së ardhshme të Farës së fikut të shenjtë, e cila do të jetë në konkurrencën kryesore.

Arsyeja se pse shteti iranian kishte bërë kaq shumë për të goditur filmat e tij, tha ai, ishte se “si çdo diktaturë apo sistem tjetër totalitar, duan kontroll absolut mbi imazhet që nuk u pëlqejnë e të cilat e ballafaqojnë realitetin e tyre, qenien dhe sistemin e tyre”.


“Thjesht, përpiqen t’i trembin që të gjithë dhe t’i largojnë që të gjithë nga çdo përpjekje për të bërë filma ose për t’u shprehur ose për të përdorur lirinë, vetëm për shkak të këtij iluzioni kontrolli”, tha ai. “Prandaj, mesazhi im për kolegët e mi, për kineastët e tjerë është: ka zgjidhje”.

/Telegrafi/



EURO GLASS
 Adr: Fushë Kosovë
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@live.com

Sport



City rëmbeu titullin e 10-të, Chelsea dhe Unitedi jashtë LK-së

MANCHESTER, 19 MAJ - Manchester City është kampion i Premier Ligës për sezonin 2023-2024. Skuadra e Pep Guardiola's fitoi 3-1 ndaj West Ham United në javën e fundit të kampionatit. Docieta e Foden vendosi ndeshjen në shinat e duhura, ndërsa goli i Kudus shërbeu vetëm për statistikë, pasi Rodri thelloi

shifrat në fillimin e pjesës së dytë. City "kurorëzon" kështu sezonin në mënyrën më të mirë të mundshme, për ta ky është titulli i 10-të në histori dhe i katërti radhazi. Arsenali duhet të provojë sërish vitin tjetër për të arritur të suksesi në Premier Ligë, ekipi i Artetës fitoi 2-1 me Everton. Chelsea në sezonin e ardhshëm do të

luajë në Ligën e Konferencës, pasi e mbylli në vendin e 6-të, ndërkohë që Unitedi mbeti jashtë zonës evropiane. Jurgen Klopp mbylli eksperiencën e tij 8-vjeçare në krye të Liverpoolit. Skuadra e trajnerit gjerman e mbylli sezonin me fitoren 2-0 ndaj Wolves, duke u renditur në vend të tretë me 82 pikë.

Triumfon Ylli, titulli vendoset në Mitrovicë

SUHAREKË, 19 MAJ - Golden Eagle Ylli ka barazuar serinë finale në 2:2, ku titulli do të vendoset të enjten në Mitrovicë. Therandasit fituan ndaj mitrovicasve me rezultat 75:71 (13:15, 16:18, 20:13, 26:25), në një ndeshje mjaft interesante. Të dy skuadrat treguan dëshirën e madhe për të fituar nga fillimi i ndeshjes, ku cereku i parë ishte i barabartë me "Xehetarët" që kishin deri në katër pikë epërsi, derisa kjo

pjesë përfundoi 13:15. Lojë e barabartë u zhvillua në periudhën e dytë, ku mysafirët kishin deri në gjashtë pikë epërsi, derisa pjesa e parë përfundoi 29:33. Megjithatë, Ylli rikthehet fuqishëm në periudhën e tretë, për të përmbysur shifrat në 40:38, derisa rezultati pas 30 minutash ishte 49:46. Therandasit u shkëputën edhe më shumë në dhjetë minutat e fundit, ku kishin epërsi deri në 12 pikë,

64:52, dhe deri në fund nuk e lëshuan epërsinë, duke triumfuar 75:71. Te vendasit u dalluan Jalen Nesbitt me 15 pikë e nëntë kërcime dhe Alonzo Verge JR me 27 pikë, gjashtë kërcime e shtatë asistime, kurse te mitrovicasit u dalluan Kevin Capers me 17 pikë, pesë kërcime e gjashtë asistime. Dardan Kapiti me dhjetë pikë e 11 kërcime dhe Darnell Edge me 15 pikë e gjashtë kërcime.



Ballkani siguron titullin e tretë radhazi



PODUEVË, 19 MAJ - FC Balkani ka shkruar një faqe të re në historinë e klubit, duke fituar titullin e tretë radhazi në AlbiMall Superligën e Kosovës. Një arritje kjo e jashtëzakonshme që e vendos këtë skuadër në një nivel të lartë të futbollit kosovar. Kësioj, Balkani barazon rekordin e mbajtur deri tani nga Besa e Pejës, e cila kishte dominuar elitën e futbollit tonë në vitet 2005, 2006 dhe 2007. Trajneri Ilir Daja ka udhëhequr

portokallezjinjtë drejt triumfit të tretë radhazi. Titulli u sigurua në një ndeshje mjaft interesante kundër rivalit direkt, Llapit, e cila u zhvillua në stadiumin "Zahir Pajaziti" në Podujevë. Ndeshja e parafundit e këtij edicioni ishte vendimtare, dhe ishte Bernard Karrica ai që i dha fund dilemës së minutën e 74-t. Ky gol i dha mundësi lojtarëve dhe tifozëve suharekas të fillojnë festën e merituar, teksa ceremonia


zyrtare e dorëzimit të trofeut do të organizohet nga Federata e Futbollit e Kosovës fundjavën e ardhshme, kur Balkani do të luajë ndeshjen e fundit të sezonit para tifozëve të vet kundër Prishtinës. Në ndeshjet e tjera Gjilani shënoi fitore në duel me Dritën, 2:1, Feronikeli mposhti Dukagjinin 3:2, derisa Prishtina dhe Malisheva realizuan fitore bindëse në përballjet kundër Fushë Kosovës (5:0), përkatësisht Lirisë (7:4).

Rahoveci kualifikohet në finale, Kastrioti triumfon ndaj Besës

RAHOVECI, 19 MAJ - Rahoveci është kualifikuar në finale të plejofit në Superligën e Kosovës në hendboll. Për skuadrën rahovecë është sukses historik. Rahoveci në gjysmëfinale të plejofit e eliminoi Trepçën. Fitoren e dytë ndaj Trepçës e arriti të shtunën në Mitrovicë. "Vreshtarët" fituan me rezultatin 34:28. Në fakt mysafirët kanë dominuar nga fillimi e deri në fund dhe pa shumë telashe siguruan vendin në finale. Alban Haziri i realizoi 7 gola për Rahovecin, ndërsa nga 5 i kishin

Egzon Gjuka e Victor Alonso. Te Trepça, Yasmine Henahem i kishte 8 gola. Nga 5 i shënuan Sali Maxhera, Shpëtim Mehmeti e Akram El Kassasi. Në finale Rahoveci takohet me fituesin e çiftit tjetër gjysmëfinale Besa Famgasin-Kastrioti. Kastrioti ka barazuar në 1:1 rezultatin në serinë gjysmëfinale të plejofit në Superligën e Kosovës në hendboll. Kastrioti mposhti Besa Famgasin me rezultat 29:28. Ndeshja u zhvillua në palestrenë "Bill Clinton" në Ferizaj në praninë e një numri të madh shikuesish dhe në

ambient të bukur sportiv. Ndeshja ishte e fortë dhe skuadrat kanë luftuar nga fillimi e deri në fund. Vendasit megjithatë ishin vazhdimisht në epërsi, kurse Besa vetëm ka barazuar dhe atë në pjesën e parë. Në të dytën Kastrioti ka mbajtur epërsinë deri në fund. Deniz Terziqi ishte më efikas me 12 gola, 7 i kishte Luzlim Shabani. Te Besa, 6 gola i kishte Arbios Mushkolaj, kurse nga 5 i realizuan Nikola Prcce e Marin Mariq. Ndeshja e tretë dhe vendimtare zhvillohet mesjavën e ardhshme në Pejë.



Thirrja për aplikim (DHËNJË TË OFERTËS)

"NAZMI M.SADIKU" B.I. me Numer Unik.Biz: 812154110 me seli rruga Milazim Sadiku nr 15.Pestove, Komuna Vushtrri me pronar Nazmi Sadiku , po kërkon një ofertues/kontraktor/kompani të interesuar dhe të kualifikuar që të dorëzojë një ofertë/propozim për mallrat/punët/shërbime këshilluese si në vijim:për kompanit e Interesuara për Ofertim të këtyre Makinerive dhe Paisjeve Bujqësore dhe energji solare:

1. Traktor Landini 4x4 90 hp ,
2. Rimorkio 6 ton Mishel Premium,
3. Freze 205 cm maschio gaspardo ,
- 4.Pllug 2 x 2 unlu,
- 5.Sperkatese e Traktorit 800 l hidraulike 15 M,
- 6.Pijatore compact alpler 20-560 ,
- 7.Mollqer mnv agro,
- 8.Mbjellose e Qepeve automatike
- 9.Shperndarese e Plehut kimik
- 10.Energji Solare 4 kw.

**sqsarim paisjet dhe makinerit nga pika 1-10 mund te ofrohen nga kompanit e interesuara edhe me Brende-Marka tjera me specifika ekuivalente.

Kompanitë e interesuara duhet të kontaktojnë direkt tek "NAZMI M.SADIKU"B.I. –NAZMI SADIKU (Përfutuesi) nëpërmjet e-mailit apo telefonit për të kërkuar një Ftesë për Kuotim tek adresa e cekur më poshtë

Afati për të kërkuar një Ftesë për Kuotim/sqsarime tek adresa e cekur më poshtë (5 ditë nga data e publikimit)

Afati i dorëzimit të Ofertave **10 ditë nga data e pranimit të ftesave** për kuotim, ofertat dorëzohen në Adresen: rruga Milazim Sadiku nr 15.Pestove, Komuna Vushtrri

Për Informata Shtesë tel: +383 44 264 194 dhe në email adresën: nazmi.sadiku@outlook.com



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjeipuneshpelt

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Albana Kelmendi shpall te pavlefshme dëftesat sh.m.e. " Ymer Prizreni " Prizren.

- Arif Morina shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën Q.K "11 Marsi" Prizren.

- Gazmend Imeri shpall te pavlefshme dëftesat, diplomën , gjenden e notave dhe mungesave Q.K. "11 Marsi " Prizren.

- Leonard Kadjomqaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl V- IX shfmu " Pjeter Budi " Lubizhd e Hasit.

- Ardora Vezaj shpall te pavlefshme dëftesat, certifikatën, diplomën Q.K "11 Marsi" Prizren.

- Egzon Sadikaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu " Heronjtë e Lumes " Vermice.

- Qamil Krasniqi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII sh.f.m.u. " Brigada 125 " Medvec.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afer Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veterinikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

Lume's Details

Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



ROYAL CROWN
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

(Listed in alphabetical order)

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Industria e Comercio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola CeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zulal CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales

RC cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1929

RC cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1929

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

